



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0781

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga XX duke vendosur sipas ankesës së Operatorit ekonomik (OE) Gëzime S. Gashi B.I., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje” me numër të prokurimit 632-23-8985-1-2-1 inicuar nga KOMUNA E GJAKOVËS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, më 23/11/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e Gëzime S. Gashi B.I. me nr. 2023/0781, e datës 11/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje”, me numër të prokurimit 632-23-8985-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, ndërsa vendimi i AK i datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e lartcekur mbetet në fuqi.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.08.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru për ngrohje” me numër të prokurimit 632-23-8985-1-2-1. Ndërsa me datën 28.09.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë e OE “AOME” sh.p.k.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 53,300.00 €.

Me 02.10.2023, OE Gëzime S. Gashi B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën

për rishqyrtim.

Me 11.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Gëzime S. Gashi B.I., me nr. 781/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me dru për ngrohje” me numër të prokurimit 632-23-8985-1-2-1 inicuar nga Komuna e Gjakovës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Gëzime S. Gashi B.I., janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se : “Për shkak të problemeve teknike në e-prokurim dhe për arsye se kontabilisti kishte të bënte me zhvillime në veri nuk ka kuptuar kërkesën për sqarime të AK –Komuna e Gjakovës. Kontabilistit ishte i afërt me familjen e policit të vrarë Afrim Bunjaku dhe për shkak të problemeve teknike nuk ka mundur ta hap kërkesën për sqarime. Ne Grupi i OE “RRON 2019 & N.P.T “METI COMERC” jemi me të lirë me çmim dhe janë të përgjegjshëm, andaj kërkojnë nga zyrtari përgjegjës i prokurimit për arsye të rrethanave të paraqitura më lartë të i’u jepet një afat shtesë qoftë edhe për një ditë për ti dhënë sqarimet lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30/10/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 781/23, ndërsa me datë 10/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0781 me rekomandimet si në vijim:“*ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e Gëzime S. Gashi B.I, ekspertja shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës ka sqaruar se AK Komuna e Gjakovës, me datën 21.09.2023 përmes letrës standarde për sqarimet e tenderit ka kërkuar nga OE ankues sqarime për kërkesat e Përshtatshmërinë profesionale, Kapacitetin ekonomik financiar, Kapacitetin teknik dhe profesionale, po ashtu në këtë kërkesë të AK-së ceket se përgjigjet duhet të pranohen përmes platformës së e-prokurimit deri me datën 25.09.2023.

Meqenëse OE nuk kishte kthyer përgjigje, AK ka vazhduar me operatorin ekonomik të dytë me radhë me çmim më të lirë, ku me datë 27.09.2023 përmes njoftimit B58 ka njoftuar me rezultatet për këtë aktivitet të prokurimit duke e rekomanduar për kontratë OE “AOME” Sh.p.k.

OE ankues i pakënaqur me këtë njoftim ka parashtuar kërkesë për rishqyrtim me datën 03.10.2023. Ndërsa, AK me datë 06.10.2023 nëpërmjet vendimit e refuzon kërkesën për rishqyrtim dhe vërteton njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Ekspertja shqyrtuese vlerëson se autoritetit kontraktues me të drejtë ka vepruar në këtë rast për faktin se kishte kërkuar sqarime nga OE ankues dhe i ka dhënë kohë të mjaftueshme operatorit ekonomik për të kthyer përgjigje me sqarimet e kërkuara por OE ankues nuk kishte kthyer përgjigje sipas kërkesës së AK-së. Sa i përket arsytimit të OE ankues se *“për shkak të problemeve teknike në e-prokurim dhe për arsye se kontabilisti kishte të bënte me zhvillime në veri nuk ka kuptuar kërkesën për sqarime të AK –Komuna e Gjakovës”*, Ekspertja shqyrtuese sqaron se për arsytimin e parë, OE ankues nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo ndonjë kërkesë drejtuar Krpp-së që ta vërteton/verifikon se sistemi ka pas probleme, ndërsa sa i përket arsytimit të dytë, ekspertja shqyrtuese sqaron se pa marr parasysh ngjarjet e renda në veri të vendit, nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore që përjashton mos kthimin e përgjigjes në kërkesën e AK-së. Andaj, operatorët ekonomik të cilët shprehin interes për një aktivitet të prokurimit, duhet të jenë vigjilent dhe përgjegjës për kërkesat dhe afatet ligjore të cilat janë të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi. (Provë: Kërkesa për sqarime të tenderit nga AK -Komuna e Gjakovës)

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues Gëzime S. Gashi B.I Argumentimi në raportin e ekspertës shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet

relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës shqyrtuese mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Gëzime S. Gashi B.I,sh.p.k., janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit duke pasur parasysh edhe rekomandimin e ekspertës shqyrtuese. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru per ngrohje” me numër të prokurimit 632-23-8985-1-2-1, pasi që me datën 21.09.2023 përmes letrës standarde për sqarimet e tenderit ka kërkuar nga OE ankues sqarime për kërkesat e Përshtatshmërinë profesionale, Kapacitetin ekonomik financiar, Kapacitetin teknik dhe profesionale, po ashtu në këtë kërkesë të AK-së ceket se përgjigjet duhet të pranohen përmes platformës së e-prokurimit deri me datën 25.09.2023. Por OE ankues nuk kishte kthyer përgjigje sipas kërkesës së AK-së brenda afateve të përcaktuara. E që në fakt i njëjti meqë ka shprehur interes për aktivitetin e prokurimit të lartcekur, do duhej të respektoj kërkesat e AK dhe afatet ligjore.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Si dhe OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar argumente bindëse që do të ndryshonin vendimin e AK-së e po ashtu rekomandimin e ekspertit shqyrtues, andaj duke u bazuar nga të gjitha si që u thanë si më sipër është vendosur që ankesa të refuzohet si e pa bazuar ndërsa vërtetohet Vendimi i AK - B58 të datës 28.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru per ngrohje” me numër të prokurimit 632-23-8985-1-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Gëzime S. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: